

15.05.2024

PËRSHKRIM:

Organizata YMCA MOVEMENT- YMCA LEVIZJE shpall konkurs për pozitë të hapur:

Asistent/e i/e projektit

Vendi i punës: Komuna e Gjakovës

Kohëzgjatja: 1 vit me mundësi vazhdimi (part time)

Rreth organizatës:

YMCA është një organizatë e bazuar në vlerat e vullnetarizmit që synon të frymëzojë dhe inkurajojë lidhësin mes të rinjve dhe të ndihmojë në zhvillimin e shëndetshëm të komunitetit. YMCA është anëtare e plotë e Federatës së Evropiane dhe Botërore të YMCA-së. YMCA është organizata e parë rinore në botë e themeluar në 1844.

Rreth projektit:

Innovation HUB Gjakova është një program që u ofron të rinjve mundësinë për tu takuar dhe zhvilluar idetë e tyre përmes metodologjive Upshift, Podium dhe Ponder. Ky projekt zbatohet në partneritet me Zyren e UNICEF-it në Kosovë.

Përgjegjësitë kryesore:

- Ndhmon në organizimin e aktiviteteve të projektit dhe takimeve javore për të rinjtë,
- Ndhmon në organizimin e takimeve me shkollat përkatëse dhe palët e interesuara,
- Ndhmon në përgatitjen e materialeve dhe kërkesave zyrtare për takime,
- Të ndihmojë dhe të marrë pjesë në takimet zyrtare kur është e nevojshme,
- Ofron mbështetje të përgjithshme administrative dhe organizative sipas nevojës,
- Të ndihmojë në procesin e monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të projektit të udhëhequr nga të rinjtë,
- Angazhohet dhe ndihmon në programe të tjera të organizatës kur nevojitet dhe kërkohet

Kualifikimet:

- Diplomë Bachelor/ apo në vitin e fundit të studimeve (preferohet në shkencë sociale, arsim),
- Preferohet përvoja e lidhur me OJQ ose vullnetarizëm,
- Aftësi të mira ndërpersonale, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup,
- Duhet të ketë një filozofi personale në përputhje me qëllimin, misionin dhe vlerat thelbësore të YMCA,
- E hapur për të punuar në orare të ndryshme, për të udhëtuar në nivel kombëtar dhe/ose ndërkombëtar,
- Preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze,

Si të aplikoni:

Kandidatët e interesuar / ju lutemi të dërgojnë një CV dhe një letër motivimi në adresën e emailit: office@ymcakosovo.com. Në temën e emailit ju lutemi shkruani pozicionin për të cilin po aplikoni. Aplikimet pranohen deri më 24.05.2024.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen për intervistë.